

Shërbimi i informimit dhe këshillimit për viktimat (Victim Information and Advice (VIA)) Si mund t'ju ndihmojmë

Ju lutemi kontaktoni VIA-në nëse e doni këtë dokument në një gjuhë tjetër, me germa të mëdha, në audio, në brail ose në një format tjetër. Ne i mirëpresim telefonatat nëpërmjet sistemit shkruaj dhe fol (typetalk) RNID në prefiksin 18001.

Si mund t'ju ndihmojmë Informacion dhe këshilla

Nëse jeni prekur nga krimi, mund t'ju duhet të keni të bëni me sistemin e drejtësisë kriminale.

Kjo gjë mund t'ju sjellë tension ose mund t'ju çorientojë ndërkohë që përpiqeni të përballoni pasojat fizike dhe emocionale të krimit.

Shërbimi i informimit dhe këshillimit për viktimat (Victim Information and Advice (VIA)) është pjesë e Shërbimit të zyrës së mbretërisë dhe Prokurorit fiskal. Prokurori fiskal është përgjegjës për hetimin dhe paditjen e krimit në Skoci.

Punonjësit e VIA-së nuk janë prokurorë. Puna jonë është të ndihmojmë viktimat, dëshmitarët si edhe në disa raste të afërmit më të afër kur ju ka vdekur dikush menjëherë dhe pa pritur si pasojë e një krimi.

"Shërbimi dhe punonjësit tuaj më kanë ndihmuar shumë gjatë të gjithë kohës, veçanërisht sepse unë nuk kam patur të bëj me sistemin tonë ligjor më parë."

Çfarë mund të bëjë VIA-ja

VIA-ja mund t'ju ndihmojë duke:

ju ofruar ndihmë dhe këshilla rreth mënyrës se si funksionon sistemi ligjor dhe se çfarë mund të prisni.

t'ju informojë për ecurinë e çështjes tuaj

organizojë që ju të vizitoni gjykatën përpara gjyqit

t'ju vërë në kontakt me shërbime të tjera për viktimat dhe familjet e tyre.

Në qoftë se në një moment ju nuk e doni më ndihmën tonë, thjesht na njoftoni. Nëse ndërroni përsëri mendje, ju lutemi na kontaktoni.

Kë mund të ndihmojmë ne

VIA-ja ndihmon viktimat dhe dëshmitarët e krimeve të raportuara tek Prokurori fiskal të cilat përfshijnë:

Dhunë në familje

Krime raciste

Shkelje seksuale

Viktimat dhe dëshmitarët fëmijë

Krime të tjera të rënda

Ne gjithashtu ndihmojmë:

Të afërmit më të afërm në raste vdekjesh gjatë procedurave penale, ose në rastet kur bëhet një shqyrtim për aksidente vdekjeprurëse ose kur bëhet një hetim i gjerësishëm.

Dëshmitarë të prekshëm, viktimat ose të afërmit më të afërt.

Një person mund të konsiderohet si i prekshëm nëse ai/ajo ka nevojë për më shumë mbështetje; për

shembull, nëse anglishtja nuk është gjuha e tyre e parë, ose ata kanë probleme me të mësuarit.

“Shërbimi që ne ofrojmë është tepër i rëndësishëm. Unë nuk e imagjinoj dot se si mund t’ja kisha dalë pa ndihmën tuaj”

“Ne kishim organizuar një vizitë paraprake në gjykatë...Unë vetëm mund t’ju falënderoj që ma kthyet një situatë shqetësuese në një mjedis të tolerueshëm.”

“Shërbimi dhe punonjësit tuaj më kanë ndihmuar shumë gjatë të gjithë kohës, veçanërisht sepse unë nuk kam patur të bëj më parë me sistemin tonë ligjor.”

Ju lutemi vini re

VIA-ja nuk mund të vendosë ose influencojë se kush paditet për një krim ose për paditë për të cilat akuzohen. Ai që e merr këtë vendim është Prokurori fiskal i cili vendos duke u bazuar në provat që ka dhe nëse është në interes të publikut që të padisë.

Nuk është e mundur që një person që është prekur nga krimi ta "abandonojë çështjen". Është Prokurori fiskal ai që merr edhe këtë vendim.

VIA-ja nuk mund të ofrojë konsulta ose ndihmë financiare, megjithatë ne mund t’ju vendosim në kontakt me agjenci të tjera që mund t’ju ndihmojnë.

Informacion i mëtejshëm

Ju lutemi kërkoni nëpërmjet VIA-së nëse do të donit të merrni informacion të mëtejshëm ose nëse ka ndonjë gjë për të cilën jeni i pasigurt.

Ju gjithashtu mund të kontaktoni Mbështetjen për viktimat në Skoci (Victim Support Scotland (VSS)), një organizatë vullnetare e cila ofron mbështetje praktike dhe emocionale për ata që janë prekur nga krimi:

0845 60 39 213 gjatë orarit të punës
0845 30 30 900 në mbrëmje dhe gjatë fundjavës

www.victimssupportscotland.org.uk

Kontaktimi VIA-në

Për më shumë informacion ju lutemi kontaktoni zyrën tuaj lokale të VIA-së, në numrin e telefonit në letrën bashkangjitur.

Ose kontaktoni ekipin kombëtar të VIA-së

Nëpërmjet telefonit në numrin 01389 739557

Ose nëpërmjet vianationalteam@copfs.gsi.gov.uk

www.crownoffice.gov.uk

Informacioni në këtë fletushkë gjendet në gjuhë dhe formate të tjera.

Ju lutemi kontaktoni VIA-në për të detajet.